

E ARDHMJA E VENDIT TIM ËSHTË...

Barazia *TOLERANCA* *SOLIDARITETI*


Edhje e shprehur **LIRIA + RESPEKTI**

= **DEMOKRACIA**

Edhje e lojës *Edhje e mirë*

INSTITUCIONI MË I LARTË LIGJVËNËS

ALTIN (12), MARIGONA (11), BESFORT (11), VLERA (12), RINETA (11), ERBLIN (12), AULON (11)



A dëshironi të dini se cili është institucioni i cili propozon dhe miraton ligje? A e dini se sa deputetë i ka Kuvendi i Republikës së Kosovës? A keni menduar ndonjëherë se çfarë vlere të madhe kemi ne në një shtet demokratik? Këto informata mund t'i lexoni në këtë artikull

Është kënaqësi shumë e madhe të mësojmë dhe të shkruajmë për institucionin më demokratik, që propozon dhe miraton ligjet. Ky institucion është Kuvendi. Aty ku diskutohen çështjet më të rëndësishme të cilat janë preokupim për neve, qytetarët. Si për shembull, çështjet që lidhen me arsimin, shëndetësinë, ekonominë, etj. Kuvendi si organi më i lartë ligjvënës na siguron të gjithëve mirëqenie sociale.

Kuvendi i zbaton të gjitha elementet e demokracisë, të tilla si: liria, toleranca, respekti, barazia, e drejta e shprehjes së lirë, etj. Me këtë nënkuptojmë se aty përveç deputetëve të komunitetit shumicë që jemi ne kombi shqiptar, përfshihen edhe komunitetet e tjera jo shumicë si: serb, boshnjak, turk, etj. Në Kuvend punojnë 120 deputetë, të cilët i ka zgjedhur populli përmes votave. Këta deputetë janë zëri i popullit në Kuvend. Për këtë arsye, funksioni i parë i Kuvendit është funksioni përfaqësues. Siç e kemi cekur më lart, Kuvendi propozon dhe miraton ligjet. E ky pikërisht është funksioni tjetër i Kuvendit, i cili njihet si funksioni legjislativ. Pas marrjes së ligjeve është institucioni i Qeverisë, ai i cili i vë në funksion këto ligje. Për këtë arsye Ku-



Së bashku do të kontribuojmë për demokracinë vendi ka edhe funksion kontrollues. Seancat plenare udhëhiqen nga Kryetari i Kuvendit dhe pikat e rendit të ditës caktohen nga kryesia e Kuvendit. Ne sot do ta kemi rastin ta vizitojmë Kuvendin dhe ta shohim nga afër këtë institucion që kujdeset për të ardhmen dhe zhvillimin e shtetit tonë. Kjo tregon se ne kemi filluar të jemi qytetarë aktiv dhe të interesuar për shtetin tonë. Bëhuni edhe ju pjesë e zhvillimit shtetëror.



Ne jemi autorët e këtij artikulli

FUQIA E POPULLIT

RINESA (11), ALBI (11), ERONITA (11), DRILON (11), LORENT (12), VALON (11), ALMA (11)



Të jesh një qytetar aktiv do të thotë të jesh i mirë me të gjithë. Në këtë artikull ne kemi shkruajtur se si mund të jemi të gjithë qytetarë aktiv

Ulem dhe mendoj se a jam e lumtur. Po, them me vete. Por, ndalem e them, nëse unë jam e lumtur dhe të tjerët nuk janë të lumtur, a do të ishte Kosova një vend i mirë? Të jesh i lumtur do të thotë t'i ndihmosh popullit tënd. Në Kosovë jetojnë afërsisht 1.8 milionë banorë. Ama nuk janë të gjithë shqiptarë. Disa janë turq, serbë, boshnjakë, apo i përkasin ndonjë feje tjetër. Por, të gjithë janë të regjistruar në regjistrin civil, dhe fëmijët e tyre rriten në Kosovë.

Të jesh një qytetar aktiv do të thotë të votosh dhe të jesh i lirë të marrësh pjesë në debate publike. Që të dalësh të votosh duhet të jesh 18 vjeçar. Ne nuk kemi të drejtë t'i themi njëri-tjetrit se kë të votojnë, sepse të gjithë duhet të marrim vetë këtë vendim.

Për të qenë një qytetar aktiv duhet t'i kesh të drejtat themelore në jetë. E drejta e parë themelore është e drejta për jetë, pastaj është e drejta për emër, e drejta për familje, e drejta për ushqim, e drejta për barazi, e drejta për mbrojtje dhe siguri, e drejta për argëtim, e drejta për shprehje e një mendimi të lirë, e drejta për të pasur ambient të pastër, e drejta të shkollohemi, etj. Të gjitha këto të drejta duhet të jenë të barabarta për të gjithë dhe të respektohen nga të gjithë. Në këtë mënyrë do të kemi mirëqenie të përgjithshme pa dallim feje, gjinie, race, kombi, prejardhje, etj.

Ne besojmë se Kosova është e barabartë, edhe pse ka njerëz të ndryshëm. Kur ne jemi të lumtur, vendi ynë është më i mirë.



Ashtu si ne, Kosova është me plot ngjyra



Gazetarët e artikullit



Ja çfarë bëj unë si qytetar aktiv



E drejta për ambient të pastër dhe ne duke e pastruar atë




Angazhimi i të gjithëve sjell të ardhme më të ndritur



Përfaqësuesi i së ardhmes



Deputetët janë përfaqësuesit e popullit. Ne sot kishim rastin të jemi në rolin e deputetëve. Vërtet ishte punë që kërkon shumë përgjegjësi



Demokracia ka nevojë për qytetarë aktiv



Të gjithë e gëzojmë të drejtën e shprehjes së lirë

E DREJTA PËR TË ZGJEDHUR

ALBIM (11), DION (11), JETMIR (11), AGON (11), ENDRIT (11), EDONISA (11), RREZARTA (12), SARA (11)



Zgjedhjet janë urëlidhëse mes popullit dhe qeverisjes. Kjo shihet edhe nga kuptimi i fjalës demokraci si formë e qeverisjes shtetërore. „Demos“ - popull dhe „kratos“ - qeverisje

Të dashur lexues, së pari faleminderit që keni zgjedhur të lexoni artikullin tonë. Ne iu premtojmë që nuk do të zhgënjeheni aspak për këtë përzgjedhje. Po ashtu, do të mësoni shumë gjëra të reja për zgjedhjet.

Dëshirojmë të fillojmë me nocionin e zgjedhjeve, se si ne si fëmijë i shohim dhe perceptojmë zgjedhjet. Pastaj, do të ndalemi pak dhe t'iu tregojmë për llojet e zgjedhjeve. Për ne, zgjedhjet janë elementi bazë i demokracisë. Kjo sepse çdo njëri prej nesh është i lirë të vendos vetë për të ardhmen. Mundësinë për të zgjedhur e kemi atëherë kur kemi më shumë se një alternativë. Si shembull konkret të kësaj, marrim zgjedhjet të cilat i zhvilluam ne sot në grupin tonë. Pasi që grupi ynë përbëhet prej tetë anëtarëve, ne të gjithë i ndamë detyrat, në mënyrë që të gjithë të japim kontributin për këtë artikull. Kjo ishte sa i përket zgjedhjeve tona brenda grupit të vogël.

Tash do të flasim për rëndësinë e zgjedhjeve demo-

kratike. Nuk ka asnjë sistem demokratik pa zgjedhje të lira, të përgjithshme, demokratike dhe të drejta. Sovraniteti i popullit në demokraci realizohet përmes pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Kjo pra, arrihet përmes zgjedhjeve.

Në vendin tonë, qytetarët të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin zgjedhor. Pra, të votojnë në zgjedhjet qendrore dhe ato lokale. Në zgjedhjet qendrore, qytetarët votojnë për deputetët, të cilët ndryshe quhen përfaqësues të popullit. Kurse, në zgjedhjet lokale qytetarët votojnë për kryetarin e komunës së tyre dhe asamblenë komunale. Mirëpo, kur qytetarët arrijnë këtë moshë, përpos që e fitojnë të drejtën për të zgjedhur, ata po ashtu e gëzojnë edhe të drejtën për t'u zgjedhur.

Së këndejmi, zgjedhjet janë thelbi i demokracisë apo më mirë të themi mjeti me të cilin demokracia funksionon.



Këtu kemi vizatuar kutinë e votimit



Autorët të cilët shkruajtën për zgjedhjet



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Ali Hadri“
Klasa: VI-2
Vendi: Mirash, Ferizaj